



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË LUSHNJË
KËSHILLI I GJYKATËS**

Nr. Prot

Lushnjë, më 08.11.2023.

**SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR**

**NË KATEGORINË EKZEKUTIVE SPECIALIST I BURIMEVE
NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE.**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56/7, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të liranë shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Vendimit nr..960. prot, datë 23.10.2023 të Këshillit të Gjykatës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

1 (një) pozicion – SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE .

kategoria e pagës IV-2

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës në pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

Afati për dorëzimin e dokumenteve **23.11.2023**

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

Afati për dorëzimin e dokumenteve **30.11.2023**

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin Specialist i Prokurimit Publik:

- a) Ndihej në krijimin dhe administrimin e Regjistrimit të Personelit të Gjykatës si dhe të dosjes personale për të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të punonjësve të tjerë të gjykatës, sipas ligjit;
- b) Harton dokumente dhe programe që lidhen me personelin, si pajisja dhe plotësimi me librezat e punës, përpilimi i kontratave individuale të punës dhe nënshkrimi i tyre nga punëdhënësi e punëmarrësi, përpilimi i grafikut të lejeve vjetore për personelin administrativ;
- c) Ndihej në kryerjen e detyrave që lidhen me hartimin e përshkrimeve të punës, si dhe çështje të tjera që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë sipas ligjit;
- ç) Ndihej në procesin e rekrutimit të punonjësve të tjerë të gjykatës sipas ligjit, duke përgatitur të gjitha dokumentet dhe aktet e nevojshme për këtë qëllim;
- d) Merr masa për t'i plotësuar personelit të gjykatës materialet e nevojshme kancelarike dhe çdo pajisje tjetër, kujdeset për plotësimin e kërkesave për karburant e pjesë këmbimi të automjeteve të institucionit dhe siguron gatishmërinë e mjeteve, kujdeset për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe të zyrave, për sigurimin me energji elektrike dhe lidhje telefonike, si dhe për krijimin e lehtësirave të nevojshme për veprimtarinë e gjykatës;
- dh) Merr masa për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve dhe aparaturave, dhe kur konstatohet se dëmtimet e tyre kryhen me faj, nxjerr përgjegjësinë personale dhe parashtron propozimet për zhdëmtim;
- e) Kontrollon përdorimin me korrektësi të mjeteve, pajisjeve dhe automjeteve, si dhe ndalon çdo keqpërdorim e shfrytëzim abuziv të tyre;
 - ë) Kryhen në mënyrë periodike respektimin e orarit të punës të stafit të gjykatës dhe raporton pa vonesë tek kancelari;
 - f) Kryen proceset e prokurimeve në sistemet përkatëse sipas parashikimeve ligjore, në bashkëpunim me nëpunësit e zyrës së financës, si dhe nëpunësit të tjerë të gjykatës caktuar në komisionin e vlerësimit në procedurën përkatëse të prokurimit publik për një shërbim/mall;
 - g) Bashkëpunojnë ngushtësisht me nëpunësit e zyrës së financës për realizimin e prokurimeve të nevojshme;
 - gj) ndjek dhe zbaton me përpikmëri legjislativonin në fushën e prokurimeve dhe në çdo rast informon (me shkrim apo në mënyrë verbale) kancelarin/këshillin e gjykatës, për ecurinë e procesit të një prokurimi prej pikënisjes, përgjatë dhe në përfundim të tij.
 - h) Përgatit materiale apo shkresat e ardhura në gjykatë apo të cilat do t'ju drejtohen të tretëve sipas porosive të eprorëve;
 - i) Siguron përgatitjen e materialeve informuese për çështjet e prokurimit publik të fondeve të gjykatës dhe raportimin e tyre pranë këshillit të lartë gjyqësor;
 - j) Kujdeset për ecurinë e procedurave të prokurimit publik;
 - k) informon në kohë dhe në formën e kërkuar për ecurinë e procesit dhe problematikat e mundshme, për risqet, si dhe për masat që mund të merren për të adresuar këto risqe;
 - l) Punon brenda orientimeve të dhëna nga këshilli i lartë gjyqësor dhe/ose këshilli i gjykatës dhe/kancelari;
 - ll) Siguron kontribut në vendimmarrjen e nivelit më të lartë nëpërmjet përgatitjes së të dhënave analizuuese/raportive apo çdo lloj informacioni tjetër të plotë që mbështesin linjën e rekomanduar të veprimit;
 - m) Përdor pajisjet teknike të disponueshme, si dhe sistemin e posaçëm për administrimin e buxhetit gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon(dokument nga institucioni),
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi(dokument nga institucioni);
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi: Të jetë diplomuar në drejtësi ose fusha të tjera përkatëse që janë në përputhje me këtë përshkrim të pozicionit të punës në nivelin “Master Shkencor” në drejtësi ose ekonomi;

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vjet përvojë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale.

Aftësi të tjera Aftësitë komunikuese dhe organizative;

Pasja e njohurive mesatare në përdorimin e Programeve të *Microsoft- Word dhe Excel. programi ekuivalente të sistemit të prokurimit publik;*

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
- b. Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- a. Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore.
- f. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- g. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h. Aktin e deklarimit lidhur me statusin e nëpunës civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagjia Çlirimi, Rruga Qemal Stafa, Lushnjë nëpërmjet shërbimit postar brenda dates **23.11.2023**.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike ngadata e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 24.11.2023, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ ëëë.klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçantado të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITE DHE CILESITE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET INTERVISTA

1.2. ZHVILLOHET INTERVISTA

a. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

b.. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

c. Ligji nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”

d. VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

e. Udhezimi i APP nr. 05, date 29.07.2022, “Per disa ndryshime ne manualin teknik qe

shoqeron Udhezimin nr. 05, date 25.06.2021 “Mbi perdorimin e procedures me vlere te

vogel dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”

I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej tyre dhe intervistes, nga Këshilli i Gjykatës sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;

b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,

c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është I vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës .

II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi: Të jetë diplomuar në drejtësi ose fusha të tjera përkatëse që janë në përputhje me këtë përshkrim të pozicionit të punës në nivelin “Master Shkencor” në drejtësi ose ekonomi;

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vjet përvojë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale.

Aftësi të tjera Aftësitë komunikuese dhe organizative;

Pasja e njohurive mesatare në përdorimin e Programeve të *Microsoft- Word dhe Excel. programi ekuivalente të sistemit të prokurimit publik;*

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
 - b. Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë përdiplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
 - c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f. Formular i vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
 - g. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
 - h. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces penal;
 - i. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: : Lagjia Çlirimi, Rruga Qemal Stafa, Lushnjë nëpërmjet shërbimit postar brenda dates 30.11.2023.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 01.12.2023, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo Gjykatëslistën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi meshkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrëelektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike ngadata e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data edepozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,
- b. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c. Ligji nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”

- d. VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”
- e. Udhezimi i APP nr. 05, date 29.07.2022, “Per disa ndryshime ne manualin teknik qe shoqeron Udhezimin nr. 05, date 25.06.2021 “Mbi perdorimin e procedures me vlere te vogel dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës përpozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe nëfaqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor përkatësinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat emëtoreshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës.

Këshilli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Lushnjë.

□ V.O.: Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultetit përfundimtar i gjeni në Udhezimin nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij www.klgj.al

KËSHILLI I GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË LUSHNJË

